

TRAJNIM-NGRITJE KAPACITETI, SHKOLLA “YMER DISHNICA”

- **Temat e trajnimeve**

Çfarë është një projekt - Cikli i jetës së Projektit

Fazat e Përgatitjes së Projektit: Faza e Analizës dhe Faza e Planifikimit

Teknikat e grupit NOMINAL

Matrica e Kuadrit Logjik

Prezantimi i Analizës së Aktorëve Prezantimi i Analizës së Problemit

Prezantimi i Analizës së Objektivave

Prezantim për Supozimet e projektit

Planifikimi PERT

Në këtë trajnim morën pjesë 20 të rinj nga shkolla e mesme "Ymer Dishnica" në Bashkinë Korçë, të cilët u përzgjedhën për të marrë pjesë në sesionet e formimit mbi shkrimin e projekt propozimeve. Pjesëmarrësit i përkisnin grupmoshës 15-19 vjeç, një periudhë vendimtare për zhvillimin e aftësive të tyre analitike dhe praktike. Ky trajnim synoi t'u ofrojë atyre një bazë të fortë mbi mënyrën se si mund të hartojnë dhe menaxhojnë projekte të vogla që mund të ndikojnë pozitivisht në komunitetin e tyre. Një aspekt i rëndësishëm i grupit të përfituesve ishte përfaqësimi gjinor, ku 75% e pjesëmarrësve ishin vajza/femra, ndërsa 25% ishin djem/meshkuj. Kjo përqindje reflekton një angazhim më të lartë të vajzave në iniciativat e edukimit dhe zhvillimit të aftësive të reja, veçanërisht në fushën e menaxhimit të projekteve dhe pjesëmarrjes aktive në shoqëri. Gjatë trajnimit, vajzat shfaqën një interes të theksuar për të kuptuar ciklin e projektit dhe mundësitë e financimit, duke treguar gatishmëri për të aplikuar njohuritë e reja në mënyrë praktike.

Nga ana tjetër, edhe pse përfaqësimi i djemve në këtë trajnim ishte më i ulët, ata treguan një angazhim të konsiderueshëm gjatë sesioneve të trajnimit. Djemtë u fokusuan më shumë në aspektet teknike të projekt propozimeve, si struktura financiare dhe strategjitë e implementimit, duke dhënë një kontribut të vlefshëm në diskutime dhe në ushtrimet praktike të punës në grup. Prania e një grupi të përzier gjinor krijoi një dinamikë të balancuar dhe të frytshme, ku të rinjtë ndanë perspektiva të ndryshme dhe plotësuan njëri-tjetrin në procesin e të mësuarit.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit e këtij trajnimi përfituan njohuri të reja mbi shkrimin e projekt propozimeve dhe menaxhimin e tyre, duke rritur kapacitetin e tyre për të ideuar dhe zbatuar projekte në komunitetin e tyre. Ky trajnim ishte një hap i rëndësishëm për përgatitjen e tyre për angazhimin në programe rinore dhe për aplikimin në skema financimi të ndryshme, duke i fuqizuar ata si aktorë aktivë në zhvillimin e iniciativave me ndikim shoqëror.

- **Metodologjia përfshiu këto hapat kryesorë:**

1. *Identifikimi i Nevojave të Pjesëmarrësve*

Përpara fillimit të trajnimit në shkollën e mesme "Ymer Dishnica" në Bashkinë Korçë, u realizua një analizë fillestare për të identifikuar nivelin e njohurive dhe nevojave të pjesëmarrësve në lidhje me shkrimin e projekt propozimeve. Kjo u bë përmes pyetjeve të hapura në grup dhe diskutimeve interaktive, duke ndihmuar trajnerët të kuptojnë cilat aspekte të procesit të menaxhimit të projekteve ishin më të panjohura për të rinjtë. Rezultatet treguan se pjesëmarrësit nuk kishin përvojë të mëparshme me këtë temë dhe kishin nevojë për një qasje të thjeshtuar dhe të strukturuar për të mësuar konceptet bazë.

2. *Zhvillimi i Planit të Trajnimit*

Pas identifikimit të nevojave të pjesëmarrësve, u hartua një plan i detajuar trajnimi, i cili përfshiu temat dhe konceptet kryesore që do të trajtoheshin në dy ditët e trajnimit. Për të siguruar që pjesëmarrësit të arrinin rezultate të matshme, plani u strukturua në mënyrë që të fillonte me bazat e shkrimit të një projekt propozimi, duke kaluar gradualisht në ushtrime praktike dhe diskutime të thelluara mbi procesin e aplikimit për financim.

3. *Metodologjia e Leksioneve të Drejtpërdrejta*

Trajnimi nisi me leksione të drejtpërdrejta, të mbajtura nga ekspertë të fushës së menaxhimit të projekteve. Këto leksione u përqendruan në përkufizimet bazë të projektit, fazat e tij dhe mënyrën e strukturimit të një projekt propozimi sipas standardeve të kërkuara nga donatorët. Trajnerët përdorën prezantime vizuale, shembuj praktikë dhe diskutime të hapura, duke siguruar që informacioni të ishte sa më i kuptueshëm dhe i lehtë për t'u përvetësuar nga pjesëmarrësit.

4. *Studimi i Rasteve të Suksesshme*

Një nga sesionet më të rëndësishme të trajnimit përfshinte analizën e rasteve të suksesshme të projekteve të zbatuara nga të rinjtë në Shqipëri. Pjesëmarrësit u njohën me projekte që kishin siguruar financim dhe ishin zbatuar me sukses në zona të tjera, duke mësuar mbi strukturën, përmbajtjen dhe strategjitë kryesore për përpilimin e një projekt propozimi konkurrues. Kjo i ndihmoi ata të kuptojnë çfarë e bën një projekt të suksesshëm dhe si të shmangin gabimet e zakonshme në aplikime.

5. *Ushtrime Praktike – Hartimi i Projekt Propozimeve*

Një pjesë e rëndësishme e trajnimit ishte përfshirja e ushtrimeve praktike, ku pjesëmarrësit punuan në grupe për të hartuar projekt propozimet e tyre të para. Ata u udhëzuan të zhvillonin një ide projekti nga fillimi, duke përfshirë analizën e problemit, përcaktimin e objektivave, formulimin e aktiviteteve dhe hartimin e një buxheti të thjeshtuar. Ky ushtrim i ndihmoi të rinjtë të praktikojnë përdorimin e njohurive të fituara dhe të kuptojnë procesin e ndërtimit të një projekt propozimi nga fillimi deri në fund.

6. Diskutimi dhe Komentet Konstruktive mbi Projektet

Pas përfundimit të hartimit të projekt propozimeve, secili grup prezantoi punën e tij dhe mori komente konstruktive nga trajnerët dhe pjesëmarrësit e tjerë. Ky sesion ndihmoi në identifikimin e përmirësimeve të mundshme në përmbajtjen dhe strukturën e projekteve, si dhe në rritjen e aftësive të pjesëmarrësve për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tyre.

7. Simulimi i Rasteve dhe Prezantimi i Ideve

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit morën pjesë në simulime reale, ku ata u vendosën në situata të ndryshme për të testuar aftësitë e tyre në hartimin dhe prezantimin e projekteve. Ata analizuan sfidat dhe mundësitë e një aplikimi real, duke kuptuar si të përgatisin një projekt që të jetë i realizueshëm dhe i financueshëm.

8. Diskutimi mbi Burimet e Financimit dhe Strategjitë e Aplikimit

Një aspekt thelbësor i trajnimit ishte prezantimi i burimeve të mundshme të financimit për të rinjtë dhe organizatat rinore. Pjesëmarrësit u njohën me institucionet dhe organizatat që ofrojnë mbështetje financiare për projektet e tyre dhe mësuuan si të identifikojnë thirrjet për aplikime, si të përgatisin një aplikim të suksesshëm dhe si të menaxhojnë raportimin financiar të projekteve të miratuara.

9. Puna në Grup dhe Ndërtimi i Aftësive Komunikuese

Përveç aftësive teknike mbi shkrimin e projekteve, trajnimi i ndihmoi pjesëmarrësit të zhvillojnë aftësi të rëndësishme si puna në grup, komunikimi dhe ndarja e përgjegjësive në një projekt. Ata mësuuan si të ndajnë rolet brenda një ekipi projektues, si të bashkëpunojnë dhe si të përcaktojnë afate dhe detyra për të siguruar suksesin e projektit.

- **Proçeset e grupit:**

Temat e sesioneve të trajnimit ishin interaktive. Në këtë kuadër, trajnimi gjatë të dy ditëve, ishte ndërtuar në mënyrë të tillë, që pjesëmarrësit të kishin mundësi të punonin së bashku me një individ të tjerë, si dhe në punë në grupe edhe më të mëdha. Gjatë procedimit me diskutimin e temave të ndryshme, atyre ju paraqit edhe një pyetësor për të analizuar se cilat ishin përparësitë dhe disavantazhet e shkrimit dhe zbatimit të projekti ideve në kontekste të ndryshme dhe për target grupe të ndryshme. Përgjithësisht puna në grup, rezultoi efektive dhe pjesëmarrësit ishin në gjendje që të ndërtonin ura të mira komunikimi ndërmjet tyre. Gjithashtu pjesëmarrësit arritën që në sajë të punës në grup të paraqitnin projekt-ide shumë të mira.

Si pjese e formimit të grupeve u mbajtën parasysht dhe hapat e mëposhtëm:

- **Formimi i grupit:** Trajnimi ndihmoi gjithashtu që të rinjtë të kuptojnë se si të formojnë një grup të punës të përshtatshëm për zhvillimin e projektit. Kjo përfshiu identifikimin e anëtarëve të grupit me aftësi dhe përvojë të ndryshme që mund të kontribuojnë në projektin e propozuar.
- **Komunikimi efektiv në grup:** Trajnimi inkurajoi të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre për komunikim efektiv në grup. Kjo përfshiu mësimet rreth ndërlidhjes së efektshme me anëtarët e grupit, dëgjimin e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, shprehjen e ideve dhe opinionëve me qartësi, dhe menaxhimin e konflikteve që mund të dalin në grup.
- **Bashkëpunimi dhe ndarja e punës:** Trajnimi u ofroi teknika dhe mënyra për të përmirësuar bashkëpunimin dhe ndarjen e punës në grup. Gjatë këtij sesi u panë aftësinë për të identifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e ndryshme, përcaktimin e termave të afateve dhe monitorimin e përparimit të punës në mënyrë të organizuar dhe efektive.
- **Menaxhimi i kohës:** Trajnimi i inkurajoi të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre për menaxhimin e kohës në grup dhe gjithashtu përfshiu identifikimin e detyrave me prioritet, planifikimin e afateve të punës dhe sigurimin e përmbushjes së tyre brenda kohës së parashikuar.
- **Vendimmarrja në grup:** Trajnimi ju ofroi teknika dhe mënyra për të përmirësuar vendimmarrjen në grup. Nga ky sesion të rinjtë nxorën mësimet rreth marrjes së vendimeve kolektive, mbledhjes së informacionit dhe analizës së tij, diskutimit të opsioneve të ndryshme dhe vlerësimit të avantazheve dhe dis-avantazheve të secilës opsion.